




Planuar / Doretuar Prilbim / Prilbim Received / Delivered	15.07.2022	2	viti god year
Organ / lista Organ / lista Org / list	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kohëzma Quantity
SKINVEST	4156/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.505/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.505/2022 të datës 07.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me banim në fshatin

kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues të Komunës së Vitisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.505/2022 e datës 07.06.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi i Komisionit Vlerësues Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë të Komunës së Vitisë, lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit me numër të protokollit 02-320/04/-193 të datës 17.05.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 07.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3309/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit pa numër dhe datë të Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë të Komunës së Vitisë, me pretendimin se Komisioni Vlerësues ka qenë jo profesional dhe tendencioz.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Vitisë. Me datë 15.06.2022 Këshilli ka pranuar nga Komuna e Vitisë përgjigjen në ankesë si dhe shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 3309/2022 të datës 07.06.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Komisionit Vlerësues në Komunën e Vitisë pa numër dhe datë; Emalin e datës 03.06.2022 nga SIMBNJ për ankuesin; Emalin e datës 24.05.2022 nga _____ për ankuesin; Ankesën me numër protokollit 02-320/04/940 të datës 17.05.2022 të ankuesit e parashtruar pranë Komisionit Vlerësues për Lëvizje brenda Kategorisë; Konkursin me numër reference RN00008721 të datës 29.03.2022 për pozitën Zyrtar për Bujqësi; Dokumentin e datës 15.12.1990; Dokumentin e datës 20.06.1987; Dëshmi lidhur me punimin e diplomës të datës 26.12.1990; Formularin për aplikim të datës 18.06.2019; Aplikacionin e pagesave direkt për sipërfaqe të datës 13.03.1989; Formularin për aplikim të datës 21.05.2019; Aplikacionin e pagesave direkt për sipërfaqe të datës 28.04.1964; Formularin për aplikim të datës 17.06.2019; Formularin për aplikim të datës 25.06.2019; Formularin për aplikim të datës 27.06.2019; Aplikacionin e pagesave direkt për sipërfaqe të datës 17.03.1951; Aplikacionin e pagesave për sipërfaqe të datës 13.09.1978; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3362/2022 të datës 09.06.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3491/2022 të datës 15.06.2022; Njoftimin për përfundimin e procedurës së konkursit për lëvizje paralele të Zyrtarit të Bujqësisë i datës 16.05.2022; Vendimin me numër 02-035/02-468 të datës 29.04.2022 për themelimin e komisionit të vlerësimit; Njoftimin e Burimeve Njerëzore; Emalin e datës 24.05.2022; Vlerësimi i intervistës me gojë nga anëtarja e kryesuesja e komisionit të vlerësimit _____ Vlerësimi i intervistës me gojë nga anëtarja e komisionit të vlerësimit _____ Vlerësimi i intervistës me gojë nga anëtari e komisionit të vlerësimit _____ Vlerësimi i intervistës me gojë nga anëtari e komisionit të vlerësimit _____ Raporti i datës 11.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se Komuna e Vitisë më datë 29.03.2022 ka publikuar Njoftimin për hapje të Konkursit për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00008721 për pozitën e punës "Zyrtar për Bujqësi" në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi si kandidat i vetëm.

Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë në fazën e shqyrtimit paraprak me datë 10.05.2022 ka shpallur Njoftimin me nr.49/2022 përmes të cilit është bërë njoftimi së kandidati _____ në këtë rast ankuesi ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i nijeti do të vazhdoj me procedurën e intervistës me gojë.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategoritë sipos Raportit të datës 11.05.2022, ka përfunduar procedurën për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00008721 për pozitën e punës "Zyrtar për Bujqësi, me arsyetimin se kandidati i vetëm në këtë konkurs nuk ka arritur të merr pikët e kërkuara sipas nenit 49 të Rregullores 16/2020, respektivisht ankuesi ka arritur vetëm 43.8 pikë.

Ankuesi kundër vlerësimit të Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategoritë ka parashtruar ankesë me datë 17.05.2022 në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë, ndërsa ky

i fundit me Vendimin pa numër dhe datë ka refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se Komisioni se ankuesi ka arrit vetëm 43.8 pikë, andaj edhe procedura duhet të përfundoj pa fitues. Ankuesi këtë vendim e ka pranuar me datë 24.06.2022 përmes email adresës zyrtare dhe kundër të njëjtit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimet ankimore së Komisioni Vlerësues ka qenë jo profesional dhe tendencioz.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka vlerësuar se ankuesi në intervistën më gojë ka arritur të marrë gjithsej 43.8 pikë të pamjaftueshme për tu përzgjedhur si kandidat fitues për këtë pozitë, rrjedhimisht në kuptim të nenit 49 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar se: *Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi.....* andaj mbi këtë fakt organi punëdhënës ka përfunduar procedurën e lëvizjes brenda kategorisë pa fitues, duke vepruar në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues.....*

Përkritazi me pretendimin ankimor të ankuesit së Komisioni Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë ka qenë tendencioz dhe jo profesional, Kolegji nga analizimi i Vendimit me numër protokollit 02-035/02-468 të datës 29.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Vitisë, ka konstatuar së përbërja e anëtareve të Komisionit të Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar i Bujqësisë sipas Konkursit RN00008721 të datës 29.03.2022, është në pajtim me dispozitat e nenit 46 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa me asnjë provë nuk mund të vlerësohet se i njëjti ka qenë tendencioz apo jo profesionale në raport me vlerësimin e ankuesit në këtë procedurë.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë me rasatin e nxjerrjes së Vendimit të kundërshtuar me ankesë e me të cilin është refuzuar ankesa e ankuesit me numër të protokollit 02-320/04/-193 të datës 17.05.2022, ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozita material, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.505/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.